



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:151727

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876555

P.nr.1044/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjyquese Donikë Shala Abdyli, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit E.I., për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2234/2024, të datës 28.05.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës me datë 28.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2234/2024, të datës 28.05.2024, dhe kjo Gjykatë në bazë të nenit 495 të KPPK-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I Pandehuri E.I., nga i ati N. dhe e ëma A., e vajzërisë D., i lindur me datë ///, në Gjermani, me vendbanim në rr. "N. D." nr./ P., me numër personal 1//, me numër kontaktues ///, i pamartuar, i pa punë, Shqiptare Shtetas i Republikës së Kosovës..

ËSHTË FAJTOR

sepse:

Me datë 27.12.2023, rreth orës 08:36 në klinikën e Gjinekologjisë i pandehuri E.I., me dashje ka dëmtuar pasurinë e personit tjetër tani të dëmtuarit Klinika Gjinekologjike në QKUK-Prishtinë,

duke e bërë të pa përdorshme, në atë mënyrë që i pandehuri pasi që kishte qëndruar për një natë në korridorin e klinikës kur ishte zgjuar kishte thyer xhamat në hyrje të klinikës si dhe kishte tentuar të futej në dhoma të pacienteve, e tëra kjo vërehet edhe në video incizime, me çka të dëmtuarës Klinikës Gjinekologjike i kishte shkaktuar dëm material.

-Me çka ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata sipas neneve 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK si dhe nenin 365 dhe 495 të KPPRK-se, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

- I. I pandehuri E.I., dënohet me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) € (euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita kur ky Aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.
- II. Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet, gjykata në bazë të nenit 43 par.3 të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) € (euro) të gjobës.
- III. Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) € (euro), dhe në emër të fondit për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumë 20 (njëzet) € (euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- IV. Pala e dëmtuar Klinika e Gjinekologjisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2234/2024, të datës 28.05.2024, kundër të akuzuarit E.I., për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së. Njëherësh ka kërkuar nga Gjykata dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Sipas dispozitave ligjore Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së) për veprat penale për të cilat janë parashikuar dënime me gjobë ose burgim deri (3) tre vite, Gjykata në referim të kërkesës së prokurorisë mund të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të pandehurit do t'i shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor që nënkupton se në rastin konkret janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të KPPRK-së.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkëngjitura në shkresat e lëndës, dhe atë Deklarata e të pandehurit E.I. e dhënë në Polici me datë 18.04.2024; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit Fadil Maçastena e datës 27.12.2023; Deklarata e dëshmitarit Bahtije Krasniqi e datës 27.12.2023; Deklarata e dëshmitarit Blerim Aliu e datës 27.12.2023; Fotodokumentacioni si dhe prova të tjera që gjenden në shkresat e lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilëve vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 të KPRK-së.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me praninë e të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim më i butë ose më i rëndë.

Andaj, Gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllim i dënimit në vështirësi të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në bazë të nenit 449 të KPPRK-së, gjykata e ka obliguar të pandehurin që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 366 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2024:151727, 28.06.2024

Bashkëpunëtorja

Gj y q t a r j a

Sadete Kuqi Berisha

Donikë Shala Abdyli

KËSHILLA JURIDIKE: Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.